

SHOQERIA “ALMARINA OR” SHPK

Raport Paraprak i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis

**PER AKTIVITETIN:
“Rritje intensive e peshkut”
Shtojca II (pika 1/dh)**



Subjekti “ ALMARINA OR” shpk

Vendndodhja Perballe Gjirit te Raguzes-Karaburun-Orikum

Pergatiti materialin Ing . Sulbena BALILAJ

**ING. SULBENA BALILAJ
N.M.E. AUDITIM
MIRDSOR-EXPERTE**

RAPORT PARAPRAK I VNM PER AKTIVITETIN “AKUAKULTURE”

SHOQERIA “ALMARINA OR”SHPK

PERMBAJTJA E RAPORTIT

- 1. HYRJE**
- 2. LEGJISLACIONI**
- 3. TE DHENA MBI POZICIONIN GJEOGRAFIK TE OBJEKTIT**
- 4. TE DHENA MBI LLOJET E EKOSISTEMEVE QE LIDHEN ME OBJEKTIN – FLORA DHE FAUNA**
- 5. PERSHKRIMI I PROJEKTIT DHE PROCESIT TE PRODHIMIT**
- 6. NDIKIMET NE MJEDIS**
- 7. MASAT PER MBROJTJEN E MJEDISIT**
- 8. TE DHENA TE PERGJITHSHME PER VLERESIMIN E NDIKIMIT NE MJEDIS**
- 9. PERFUNDIME**
- 10. HARTA TE ZONES**

SHOQERIA “ALMARINA OR” SHPK

1- HYRJE

Akuakultura ne perkufizimin e saj me te thjeshte eshte kultivimi i organizmave ujore (ketu perfshihen peshqit, molusqet, krustacet dhe bimet ujore), ndersa sipas perkufizimit me zyrtar, akuakulture konsiderohet prodhimi i te gjithe organizmave ujore, te cilet rriten nga nje subjekt qe ka pronesine e tyre, i vetem ose ne forme ortakerie, gjate periudhes se rritjes. Akuakultura si shkence eshte praktikuar qe 2500 vjet me pare. Nga statistikat e FAO prodhimi i akuakultures ne shkalle globale ka kontribuar ne 23 % te prodhimit te pergjithshem peshkor, ku pjesen me te madhe (mbi 80 % e ze prodhimi i akuakultures aziatike). Edhe Shqiperia si vend me burime te bollshme ujore, si detare ashtu dhe te ujrave te embla, ka potenciale te medha per zhvillimin e akuakultures. Llojet me kryesore te specieve qe kultivohen ne Shqiperi jane edhe koca dhe levreku qe jane dy specie detare koca Sparus aurata dhe levreku Dicentrarchus labrax qe kultivohen ne kosha. Ecuria e akuakultures ne Shqiperi ka patur uljet e ngritjet e veta, ku me kalimin Shqiperise ne rregullat e ekonomise se tregut ndryshoi dhe sektori i akuakultures. Aktualisht, keto vitet e fundit kane marre nje perparesi me te madhe kultivimi i troftave sidomos ne zonat jugore te vendit te pasura me burime hidrike. Nderkohe goxha fuqishem eshte zhvilluar dhe kultivimi me kosha ne det i koces dhe levrekut, sidomos ne bregdetin jonian qe dallohet per ujra te thella dhe korrente te fuqishme detare, teknologji kjo e aplikuar vetem keto 5 vitet e fundit ne Shqiperi. Disi me problematike ka qene ecuria e midhikultures ne Shqiperi.

Avantazhet dhe disavantazhet e akuakultures

Akuakultura paraqet mjaft avantazhe. Se pari eshte nje mjet mjaft i rendesishem per rritjen e mireqenies si te ekonomise shqiptare, ne pergjithesi, ashtu dhe te asaj te komuniteteve lokale ku ajo aplikohet. Perdorimi i akuakultures shpesh ul presionin e peshkimit mbi popullatat natyrore te peshqve, gje qe ndikon direkt ne ruajtjen e biodiversitetit. Shpesh madje ajo aplikohet per ruajtjen direkte te popullatave ne rrezik (p.sh. kultivimi i koranit). Shpesh here, futja e llojeve te ndryshme permireson kushtet e nje ambienti te degraduar. Megjithate dhe problemi i akuakultures duhet trajtuar me kujdes. Ne Shqiperi, ashtu si dhe ne te gjithe boten, duhet aplikuar modeli i akuakultures se pergjegjshme. Disa nga aspektet e akuakultures se pergjegjshme jane: Akuakultura nuk duhet te drejtohet duke

SHOQERIA “ALMARINA OR” SHPK

u bazuar thjesht ne aspektet ekonomike, por dhe nga ato biologjike e ekologjike; futja e llojeve aloktone (qe nuk i perkasin ekosistemit vendas) duhet te behen me shume kujdes; eshte e rendesishme qe, ne te gjitha impiantet e akuakultures, te behen analizat e nevojshme qe keto te fundit te mos ndotin mjedisin apo ta degradojne ate.

Akuakultura ne vend, si një aktivitet që priret kryesisht me rritjen e specieve ujore (peshqe molusk, krustace etj.) për qëllime ekonomike, është shndërruar sot në Shqipëri në një biznes të rëndësishëm. Në këtë vështrim elementët kryesorë në rritjen e prodhimit në akuakulturë kanë qenë veçanërisht disa prej specieve të ujërave të ëmbla (krap dhe troftë) dhe specieve detare (koce e levrek) molusqet bivalve dhe krustacet (karkaleci japonez). Akuakultura është një sektor që kërkon investime të mëdha dhe këto investime kryesisht janë bërë nga sektori privat. Këtë e tregon më mirë rritja e numrit të subjekteve gjatë vitit 2003. Një pjesë e këtyre ekonomive të peshkut janë akoma në fazat e para dhe nuk kanë filluar prodhimin, ndërsa është rritur kultivimi i troftës, duke përdorur burimet e ujërave të duhura për këtë aktivitet. Aktualisht, në drejtorinë e peshkimit, janë 13 subjekte të cilat janë duke u kompletuar me dokumentacionin përkatës për liçencim për tregtimin e troftës dhe levrekut. Megjithatë, problem në zhvillimin e këtij sektori mbetet vështirësia në furnizimin me rasate dhe ushqime

Me kerkese te zotit Sheme Kondi (specialist ne fushen e akuakultures) qe eshte dhe administrator i shoqerise “ALMARINA OR” shpk, qe do te ushtroi aktivitetin e kultivimit e te tregtimit te peshkut te llojit te koces e levrekut ne kosha lundrues, ne gjirin Raguza-Karaburun - Orikum, u krye rikonjucioni i nevojshem, per te vleresuar raportet qe krijon ky objekt me mjedisin perreth me qellim qe te percaktohet vleresimi i ndikimit ne mjedis ku do te zhvillohet aktiviteti.

Raporti paraprak i vleresimit te ndikimit ne mjedis per aktivitetin e kultivimit te peshkut ne kosha lundrues ne ujrat detare te gadishullit te Karaburunit, qe po paraqesim se bashku me dokumentacionin shoqerues te detyrueshem, eshte nje material i permbledhur dhe argumentues, qe merr persiper te paraqesi funksionimin e aktivitetit ne fjale si te lejueshme qe ploteson kerkesat e legjislacionit ekzistues perkates.

Materiali i pergatitur paraqet shkallen e ndikimit ne mjedis te veprimtarise qe do te kryhet, si dhe masat qe duhet te merren per ruajtjen dhe mbrojtjen e gjithe ekosistemeve natyrore perreth.

SHOQERIA “ALMARINA OR” SHPK

Aktiviteti që ushtrohet nga shoqëria “ALMARINA OR” shpk, ndodhet në zonën e gadishullit të Karaburunit perballë gjirit Raguza.

2-LEGJISLACIONI :

Raporti u përgatit në bazë të akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore:

- Ligji Nr: 10431 date 09/06/2011 “ Per mbrojtjen e mjedisit”
- Ligji Nr: 10448 date 14/07/2011 “Per lejet e mjedisit”
- Ligji Nr: 10440 date 07/07 2011 “ Per vlerësimin e ndikimit në mjedis”
- Urdhërin e ministrit nr.146 date 08/05/2007 “ Per miratimin e listës së kuqe të flores dhe faunes”
- Udhezimi nr.8 i datës 27/11/2007 “Per nivelin kufi të zhurmave në mjedise të caktuara “
- Ligji 9010 të datës 13/02/ 2003 “Per administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”
- Ligji Nr.8897 të datës 16/05/2002 “ Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”
- Ligji 10463 të datës 22/09/2011 “ Per menaxhimin e integruar të mbetjeve”.
- VKM nr.435 të datës 12/09/2002 “ Per normat e shkarkimeve në ajër, në Republikën e Shqipërisë”
- VKM NR. 177 të datës 31/03/2005 “ Per normat e lejuara të shkarkimeve të lengeta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritese”
- Udhezimi nr.8 të datës 27/11/2007 “ Per nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”
- ligjin nr. 7908 date 05.04.1995 ” Per peshkimin”
- VKM nr.419 date 25.06.2014 « Per miratimin e kërkesave teposacme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A,B, dhe C për transferimin e lejeve nga një subjekt tjetri të kushteve për lejet respektive të mjedisit si dhe rregullave të liollesishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në leshimin e këtyre lejeve nga QKL- ja.

SHOQERIA "ALMARINA OR" SHPK

SEKSIONI 1

TE DHENA TE PERGJITHESHME

Zona ku do te ushtroje veprimtarine e vete kjo shoqeri ndodhet ne ujrata detare te gadishullit te Karaburunit, perballe gjirit te Raguzes, Orikum dhe merr ne konsiderate zonat e mbrojtura e ato publike, arkeologjike, monumentet e natyres, monumentet e kultures, zonat e mbrojtura e çdo zone tjeter qe mund te bjeri ndesh me legjislacionin mjedisor.

Kjo firme merr ne mbrojtje gjithë mjediset natyrore duke patur parasysh gjithë faktoret ekologjik te zones si dhe gjithë treguesit klimatik te rrethit te Vlores.

Kjo analize evidenton raportin ne studim me territorin perreth, efektet qe vijne nga "influcencat territoriale", natyrore si: fiziografia, hidrografia (burimet apo siperfaqet ujore), karakteristika te veçanta gjeologjike, klimatike (te lidhura me relievin dhe kushte speciale), zona me vlera te veçanta natyrore dhe artificiale si p.sh infrastruktura te rendesise rajonale e kombetare, afersia me qytete apo vendbanime te tjera, nyje te rendesishme transportuale etj.

Te dhena klimatike

Klima e Shqiperise eshte shume e larmishme. Kjo shpjegohet me poziten gjeografike, me lartesine mbi nivelin e detit dhe relievin kryesisht kodrinor dhe malor, te karakterizuar nga lugina te gjera dhe kanione te thella. Dallohen kater zona klimaterike te ndara ne 13 nenzona, te cilat ndihmojne mjaft ne diversitetin biologjik te pasur te vendit.

Zona ne studim ka nje klime subtropikale te ndikuar nga klima mesdhetare me nje fotoperiodizem ditor dhe stinor qe karakterizohet mjaft qarte nga stine te diferencuara termikisht, si dhe rreshje te perqendruara gjate pjeses se ftohte te vitit. Kemi nje lageshtire mesatare te ajrit qe arrin deri ne 70%.

Amplituda mesatare vjetore, si edhe e muajve me te ftohte e me te ngrohte te vitit, regjistron nje temperature te ulet me mesatare 12° C ne muajin Janar dhe temperature te larte me mesatare 32° C ne muajt Korrik-Gusht.

Zona karakterizohet nga nje vere e ngrohte me temperature te favorshme per plazh gjate nje periudhe gati 5 mujore, ku ne tre muajt e veres mund te shfrytezohen deri ne 14 ore plazh. Temperatura e detit arrin deri ne 27.2° C

SHOQERIA “ALMARINA OR”SHPK

absolute dhe minimalja 13.5° C duke u favorizuar kjo edhe nga vendodhja ne Gjirin e Vlores ku rrymat e ftohta detare jane me me pak influence.


Gjate gjithë vitit kemi mesatarisht 106 dite me diell dhe 190 dite pjeserisht te vrenjtura. Pra, gjithsej kemi gati 2,805 ore me diell ne vit. Temperatura absolute e ambientit eshte 0-33°C, temperatura relative e ambientit ne dimer eshte 4-12°C, temperatura relative e ambientit ne vere eshte 16-30°C.

Tregues klimatike te zones

Rrethi	Reshjet vjetore	Temperature mesatare	Dite me diell	Dite me shi	Dite te vraneta
Vlore	1675 mm	16.4 c	229	44	95

Rreshjet mesatare vjetore te kesaj krahine nuk i kalojne 1200 mm, megjithate kjo sasi rreshjesh eshte e mjaft e bollshme per ekosistemin e zones. Ato jane kryesisht ne formen e shirave ; debora ;eshte nje fenomen i rralle, i pranishem vetem ne zonen malore (mali i Cikes).Shiu bie kryesisht ne stinen e dimrit, nga nentori ne prill: 70 – 80% e reshjeve vjetore regjistrohen ne kete stine, ndersa 20% e rreshjeve regjistrohen ne stinen e pranveres. Shirat qe bien kryesisht gjate vjeshtes dhe dimrit jane te forte dhe sasia mesatare e rreshjeve ne dite eshte 27 mm.

SHOQERIA “ALMARINA OR” SHPK



➤ ERERAT

Zona e Orikumit zakonisht karakterizohet nga ererat qe fryjne nga verilindja dhe jugu. Ererat qe fryjne nga verilindja jane te ftohta dhe te thata dhe fryjne zakonisht ne periudhen e vjeshte-dimrit, e ndonjehere edhe ne pranvere. Ererat e jugut fryjne pothuajse ne te kater stinet dhe jane erera me lageshti e te ngrohta. Gjate vjeshtes dhe dimrit ato sjellin shira te forte, ndersa gjate periudhes se veres jane te thata e me nje intensitet te rregullt.

Gjate muajve Mars–Prill shpejtesia mesatare e eres arrin deri ne 15 m/sek, ndersa ne dy muajt pasardhes ajo arrin deri ne 2-4 m/sek. Gjate muajve te

SHOQERIA “ALMARINA OR”SHPK

pikut turistik Korrik-Gusht-Shtator, ererat kane nje shpejtesi mesatare 4-6 m/sek. Edhe muajt e dimrit kane nje shpejtesi ere te favorshme per shfrytezimin e diteve me diell, ku shpejtesia arrin 4-8 m/sek. Pra shpejtesia e eres ka maksimumin e saj ne muajt e fundit te dimrit dhe ato te pare te pranveres.

Duke qene zone bregdetare , fenomeni i eres se detit ndikon direkt ne kushtet klimatike, sidomos gjate veres. Gjate dimrit, drejtimet kryesore te eres jane nga verilindja (30 %),dhe jugore (35 %).Keto erera ne situata te vecanta sinoptike shpejtesia e eres arrin deri ne 40 m/s.Keto erera kane pergjithesisht drejtim jugor.

➤ TE DHENA SIZMIKE

Territori qe merret ne studim ben pjese ne zonen e qendres se termeteve prej 9 balle. Sipas mikrozonimit sizmik te vendit, Gjiri i Vlores eshte nje zone me levizje tektonike

Te dhena me te hollesishme lidhur me sizmicitetin paraqiten nga specialistet e Institutit te Gjeoshkences.

➤ TE DHENA GJEOLGJIKE DHE HIDROLOGJIKE

Zona e Orikumit ndodhet ne pjesen jug perendimore te Shqiperise, ne jug te qytetit te Vlores. rreth 10 km larg tij. Bashkia Orikum, si kufij administrative, kufizohet me bashkine Vlore ne veri dhe bashkine e Himares ne jug. Ky teritor ndodhet ne dy plansheta topografike te hartes me shkalle 1:25 000:

- Plansheti K-34-123-D-d (Radhima), pjesa juglindore e planshetit.
- 1 - Plansheti K-34-135-B-b (Orikumi), pjesa verilindore e planshetit.

2 - Ndertimi gjeologjik i rajonit

Formacionet kryesore qe ndertojne rajonin e studimit i perkasin Zones Jonike. Ato perfaqesohen nga gelqerore nga Jurasiku i poshem (J1) deri ne Eocen(Pg₂), nga flishi i Oligocenit (Pg₃), nga shliri i Akuitanian - Burdigalianit (Ni-a,b), nga molasat e Plioceni! dhe nga depozitimet mbulesore te Kuaternarit, qe Jane kryesisht dhera te origjinave te ndryshme.

SHOQERIA “ALMARINA OR”SHPK

➤ TE DHENA HIDROLOGJIKE

Gjiri i Vlores mbulon nje pjese te rendesishme te bregut juglindor te Kanalit te Otrantos. Gjiri ka nje gjatesi prej rreth 36 km dhe gjeresi rreth 10 km. Thellesia maksimale arrin ne 57 m. Gjiri i Vlores ka ndryshuar vazhdimisht konfiguracionin e tij per shkak te prurjeve te lumit Vjose dhe levizjeve te detit.

Hartat e meposhtme tregojne evoluimin e pergjithshem te ketij bregdeti gjate periudhes 1870 – 2001, me sedimentet detare, erozionin dhe proceset akumuluese.

Rajoni hidrografik i zones Llogara – Karaburun karakterizohet nga male te larta gelqerore me strukture poroze, te pershkueshem lehtesisht nga ujerat qe rrjedhin permes kanaleve nentokesore . Kjo shpjegon pse shumica e rrekeve dhe perrenjeve te zones kane shtrat sezonal ose te perkohshem. I vetmi perrua me ujra te rrjedhshem te perhershem eshte ai i Tragjasit, i cili e ka origjinen nga burimet karstike te Izvorit, burimi i Barcallase (Gura) dhe me i madhi, Kon – Mehilli ne zonen e vreshtave Dukate, Qyrak – Ali me te cilin furnizohet edhe Dukati edhe burimi i Honit ne Llogara .



Duke qene nje zone dolomite, uji precipiton ne fund, gje qe ben qe uji te dale ne fund te nivelit te detit.

SHOQERIA “ALMARINA OR”SHPK

Zona jone eshte nje zone e pasur me ujera nentokesore , ujerat nentokesore vijne ne tre drejtime pellg ujmbledhes perendim – lindje ; lindje -perendim dhe jug lindje – veriperendim Nje sere burimesh karstike furnizojne zonen me uje te embel, perfshi edhe ato qe derdhen ne lagunen e Orikumit. Furnizimi me uje te embel i Lagunes se Orikumit nga ujerat nentokesor eshte shume i rendesishem per ruajtjen e kushteve ekologjike te saj. Disa nga keto burime derdhen drejtpersedrejt ne det permes burimeve nentokesore nen nivelin e detit . Burimi me i madh karstike ne zone eshte ai i Izvorit , prane fshatit Tragjas. Ujerat nentokesore sherbejne edhe si furnizues me uje te pijshem per banoret vendas dhe eshte i mjaftueshem per te plotesuar kerkesat e tyre si dhe te perballoje zhvillimin potencial te turizmit ne zone . Ujerat siperfaqesore jane te rralla ne zone . Rregjimi i tyre eshte i lidhur me sasine dhe shperndarjen e rreshjeve . Ujerat siperfaqesore te perenjeve te Tragjasit jane perdorur ne te shkuaren (para vitit 1991) per ujitjen e fushave te Tragjasit dhe Rradhimes. Zona te ndotura deri me sot nuk ka, problemi mund te jete real me vone .

QENDRAT E BANUARA, TË DHENA DEMOGRAFIKE

Bashkia e Orikumit bejne pjese pervec qytetit te Orikumit fshatrat e Radhimes, Tragjasit, Dukat i Ri dhe Dukat te Vjeter. Ashtu sikurse ne te gjithë rajonin emigracioni ka sjelle nje levizje mekanike te popullsise se zones. Qyteti me i afert, pas Orikumit, eshte ai i Vlores me nje popullsi te rregjistruar prej rreth 120.000 banore. Indeksi i shteses natyrore dhe mekanike te popullsise ne rajon llogaritet rreth 1.5 %.

Popullsia e Bashkise Orikum 11762 Banore

Dukat Fshat	1620 Banore , meshkuj 855 femra 765
Dukat i Ri	3400 Banore , meshkuj1752 femra1646
Tragjas	1300 Banore , meshkuj 645 femra 655
Orikum	4500 Banore , meshkuj2259 femra2241
Radhime	942 Banore meshkuj 488 femra 454

Kjo bashki, permbledh kater fshatra : Dukat i Ri, Dukat i Vjeter, Tragjas, Radhime.

Ne kete bashki, bejne pjese edhe fshati :Tragjas i Vjeter dhe baza ushtarake e Pashalimanit.

Largesia e ketyre gjashte qendrave nga Orikumi eshte perkatesisht ne Km;
DUKAT I RI 6.7 KM

RAPORT PARAPRAK I VNM PER AKTIVITETIN “AKUAKULTURE”

SHOQERIA “ALMARINA OR”SHPK

DUKAT I VJETER 11.6 KM
TRAGJAS I RI 3.3 KM
TRAGJAS I VJETER 5.4 KM
RADHIMA 5.5 KM
PASHALIMANI 4.7 KM.



RAPORT PARAPRAK I VNM PER AKTIVITETIN “AKUAKULTURE”

SHOQERIA “ALMARINA OR” SHPK

Zona ku do te ushtroje veprimtarine e vete kjo firme, ndodhet perballe gjirit te Raguzes ne ujrat detare te gadishullit te Karaburunit, qe eshte ne juridiksionin e Orikumit te Vlores dhe merr ne konsiderate zonat e mbrojtura e ato publike, arkeologjike, monumentet e natyres, monumentet e kultures, zonat e mbrojtura e çdo zone tjeter qe mund te bjeri ndesh me legjislacionin mjedisor.

Kjo shoqeri merr ne mbrojtje gjithë mjediset natyrore duke patur parasysh gjithë faktoret ekologjik te Orikumit, Vlores si dhe gjithë treguesit klimatik te Orikumit.

Shoqeria “ALMARINA OR “shpk eshte me qender ne qytetin e Orikumit eshte e regjistruar ne QKR per te fituar te drejten per te zhvilluar biznesin e kultivimit dhe tregimit te peshqeve koce e levrek ne ujrat detare te gjirit te Vlores.

Ky person juridik do te zhvilloje kete aktivitet biznesi, akuakulture, ne ujrat detare bazuar ne ligjin nr.7908 dt. 05.04.1995 “Per Peshkimin dhe Akuakulturen “, Rregulloret e Ministrise se Bujqesise dale ne zbatim te ketij ligji si dhe Ligji Nr: 10431 date 09/06/2011 “ Per mbrojtjen e mjedisit”

- Ligji Nr: 10448 date 14/07/02011 “Per lejet e mjedisit”
- Ligji Nr: 10440 date 07/07 2011 “ Per vleresimin e ndikimit ne mjedis”

Ekonomia e kultivimit te peshkut do te ngrihet ne brendesi te Gjirit te Vlores ne thellesine e ujrave detare 35-50 m dhe prodhimi i synuar do te shkoje per konsum ne gjendje te fresket ne tregun e brendshem porse sipas mundesive edhe ne tregun e jashtem.

Zona ku do te montohet impianti i kultivimit te peshkut perfshihet si zone me perparesi zhvillimin e turizmit . Ekonomia do te perbeje nje element shume te rendesishem te zhvillimit te turizmit duke siguruar prodhim ihtik te cilesise se larte, te fresket e shume te kerkuar ne sezonin turistik .

Zona perreth qytetit Orikumit, pervec zhvillimit ne infrastrukture, urbanistike, do te risi edhe ate ekonomik nepermjet turizmit qe do te kete si mbeshtetje per furnizim edhe kete ekonomi te kultivimit te peshkut.

Kjo ekonomi sebashku me mjedisin natyror perreth shume te pasur me popullime floristike karakteristike dhe te faunes se larmishme do te bejne nje kompleks harmonik per zhvillimin e turizmit. Sebashku edhe me qendrat historike perreth kjo zone do te behet e frekuentueshme jo vetem nga turiste vendas por edhe te huaj.

SHOQERIA “ALMARINA OR” SHPK

Impianti, rasati dhe ushqimi per peshqit do te sigurohen nga teknologji te vendeve fqinje, Greqi, Itali, France.

Zona ne te cilen do te montohet impianti eshte perballe gjirit te Raguzes tereni kontinental i te cilit eshte shkembor me bimesi karakteristike te brezit te makies mesdhetare .

Klima eshte me dimer te bute e lageshti kurse vera e nxehte dhe e thate . Era ne kete zone mbizoteron nga veriperendimi dhe nga jugu me shpejtesi mesatare 2.5 m/sek. dhe rralle ka erera jugore me $V.mes.=40$ m/sek.Dite te qeta dhe pa erera shkojne rreth 45%

Zhvillimi i ketij aktiviteti ekonomik ne kete zone eshte ne perputhje me politikat kombetare dhe lokale te zhvillimit

1.1 Pershkrimi i projektit

Shoqeria “ALMARINA OR”shpk harton kete projekt mbi te cilin do te mbeshtese te gjitha veprimtarine e saj per realizimin me sukses te aktivitetit te akuakultures ne det me kosha lundues per mbareshtimin e koces dhe levrekut me qellim rritjen e konsumit te ketij prodhimi ne Qarkun e Vlores, duke synuar ne arritjen e nivelit te konsumit te peshkut ne vendet e zhvilluara.

Siperfaqja detare ku do te vendosen koshat notues dhe aksesoret perkates ne det eshte 10 hektar sipas ketyre kordinatave

Koordinatat gjeografike (per akuakulturen)

1. $40^{\circ}20'37.35''N$ $19^{\circ}25'08.69''E$	2. $40^{\circ}20'31.64''N$ $19^{\circ}25'18.05''E$
3. $40^{\circ}20'38.50''N$ $19^{\circ}25'25.96''E$	4. $40^{\circ}20'32.32''N$ $19^{\circ}25'35.50''E$

Zona ujore e Karaburunit-Orikum eshte nje zone ideale per shkak se ka nje potencial te kosiderueshem per akuakulture intensive detare koce dhe levrek dhe ka nje bollshemeri gjresh dhe siperfaqe ujore zhvillimin e akuakultures me kosha notues. Ne kete zone jane nje sere subjektesh qe ushtrojne aktivitetin e akuakultures intensive detare koce e levrek. Rasati i koces dhe levrekut do te transportohet ne bote izotermike te mbushur me uje dhe qe furnizohen pa nderprerje me oksigjen. Koshat do te jene te mbrojtura nga dy rjeta, te cilat sigurojne mbajtjen e rasatit dhe zhvillimin normal te tij ne fazat

SHOQERIA “ALMARINA OR”SHPK

fillestare. Cikli i rritjes vazhdon 12-15 muaj, kohe kur peshku arrin madhesine e pershtatshme per treg. Gjate ciklit sigurohet rritja me ane te ushqimeve te pergatitura si paleta, te pergatitura ne rruge industriale. Ushqimi qe do te perdoret do te jete i tipit skreting (eshte nder ushqimet me te mire ne treg dhe i certifikuar). Programi i ushqimit do te varet nga faktore te tille si: formula, sasia e ushqimit, metodat e ushqimit, densiteti i hedhjes se ushqimit dhe temperatura e ujit. Per periudhen e rritjes jane te percaktuara norma ditore e ushqimit sipas fazave te rritjes dhe zhvillimit te peshkut. Si rregull nje here ne muaj behet analiza e parametrave te ujit, cdo jave do te shikohet mbijetesa dhe ritmi i rritjes se peshkut. Programi ditor i te ushqyerit varet nga numri i peshqve ne kosha dhe pesha e tyre ne gr, temperatura e ujit te detit ne kosh dhe performanca termo-dinamike e ushqimit, peshqit do te qendrojne ne kosha specifike, derisa te arrijne peshen 30 gr. Teknologjia e akuakultures intensive eshte e thjeshte dhe tradicionale, por gjithsesi perdoren mjaft makineri te kohes dhe cilesore. Gjate punes mbetjet e imta qe jane ne sasira teper minimale si: plasmasi, arka peshku prej polisteroli do te grumbullohen ne nje pike te caktuar te tokes dhe do te dergohen ne vendin e caktuar nga Orikumi, per kete sherbim do te paguajme taksat prane bashkise.

Aktualisht ferma do te perbehet nga 18 kosha notues per rritjen e peshkut deri ne madhesine per tregetim.

Sasite e rasatit jane sipas objektivave ekonomike (plan-biznesit) dhe llogarite behen qe per te realizuar nje prodhim psh,1000 ton nevojiten mbi 3.000.000 rasate ($3.000.000 \times 0,33 \text{ kg} = 990.000 \text{ kg}$).

Ushqimi i peshkut do te blihet nga vendet BE dhe kryesisht Italia, Franca me kusht qe te siguroje cilesine e shërbimin me te mire, por ne radhe te pare mielli i peshkut dhe vaji i peshkut si perberes kryesore te tij te mos kene prejardhje nga organizma gjenetikesht te modifikuar.

Materiali qe do te perdoret per instalimin e impiantit te rritjes se peshkut do te jete kryesisht prej materiali plastik dhe dru praktikisht pa efekte negative ne drejtim te ndotjes se ambientit dhe nga ana tjeter lehtesisht i zmontueshem ne rast te nderprerjes se aktivitetit.

Ne projekt dhe plan biznesin e paraqitur tregohet qarte zhvillimi i ketij aktiviteti te rritjes intensive te peshkut me kosha lundrues perballe Gjirit te Raguzes-Karaburun.

SHOQERIA “ALMARINA OR” SHPK

1. Ne ciklin e pare te prodhimit shoqeria do te instaloje 4 kosha ne pranveren e vitit 2015 me nje sasi rasati prej 500.000 levrek e 700.000 koce qe parashikojne nje prodhim rreth 400-420 ton peshk.
2. Ne ciklin e dyte prodhues pranvere 2016 do te instalohen 6 kosha, 500.000 levrek e 1.400.000 koce duke pritur nje prodhim rreth 700 ton peshk.
3. Ne ciklin e trete pranvere 2017 do instalohen 9 kosha, 500.000 levrek dhe 2.450.000 koce duke pritur nje prodhim rreth 950-1100 ton.

Realizimi i ketyre treguesve kerkon investimin e rreth 6 milone Euro per tre sezone, ku llogaritet qe 50% te financohet nga ortaket dhe 50% nga shitja e produktit, qe fillon te hidhet ne treg ne mesin e vitit 2016.

Per te patur nje mbarevajtje te ekonomise se akuakultures duhet te respektohen rigorozisht rregullat higjeno sanitare dhe te sigurimit teknik te punonjesve qe do te punojne ne kete aktivitet, duke mos ushtruar asnje ndikim negative ne shendetin e populates qe banon perreth ketij subjekti

Per te siguruar impiantin nga trafiqet e mjeteve lundruese si gjate dites ashtu dhe gjate nates do te vendosen nje sere bovash te pajisura me mjete piroteknike qe do te sherbejne si mjete sinjalizuese.

Mbeshtetur ne eksperiencern tone, ne realitetin shqiptar si dhe ne standardet evropiane qe aplikohen ne ferma te tilla detare numuri i te punësuarve ne fermen eshte 50 persona duke filluar qe nga niveli menaxherial e deri tek punonjësit e thjeshte, pa llogaritur aksesin e madh qe jep kjo ferme ne treg me produktet e saj, po dhe shume kliente e furnitore qe do te jene përfitues te këtij projekti. Pas tre vjetesh numuri i punonjësve do te shkoje rreth 55 persona.

Do te punesohen gjithsej 50 punonjes dhe transporti i tyre nga qendra me e afert e banimit qe eshte qyteza e Orikumit, do te sigurohet me rruge detare nepermjet dy sallaveme fuoribord qe do te sigurojne njekohesisht edhe transportin e rasatit, prodhimit te peshkut, qe do te perdoret per rritjen e tij

Ne plan biznesin e hartuar per kete qellim jane parashikuar te detajuara te gjitha fazat vit pas viti qe do te kaloje ndertimi i impiantit deri ne futjen ne prodhim me kapacitet te plote te tij.

Rasati do te hidhet duar duar cdo tre muaj per te siguruar ritmiken e prodhimit gjithe vjetor.

SHOQERIA “ALMARINA OR”SHPK

Ushqimi eshte i briketuar i balancuar me te gjithë elementet ushqyes dhe i pershtatshem per kete lloj rritje. Ushqimi per momentin do te importohet nga Italia dhe Greqia, po ashtu dhe rasati.

Pra lenda e pare dhe e vetme qe do te perdoret gjate zhvillimit te aktivitetit do te jene vetem keto 2 elemente rasat dhe ushqim .

Mbetjet e mundshme qe do te kete nga ky aktivitet do te jene vetem mbetjet jetesore te rasatit (jashteqitje) dhe 3-5 % te ushqimit te konsumuar, praktikisht te vet pastrueshme nga ambjenti .

Gjate zhvillimit te ketij aktiviteti nuk do te kete asnje lloj mbetje apo shkarkim tjetër me pasoja negative ne ambjent.

Per funksionimin normal te procesit te prodhimit si dhe per te siguruar parametrat bashkohore te mbareshtimit te koces si dhe levrekut dhe per pasoje prodhimin e peshkut te nje cilesie shume te larte, impianti do te funksionojë si nje kompleks i vetem, se bashku me ambientet dhe pajisjet e meposhtme:

- ◆ Magazina e ruajtjes se ushqimit dhe pajisjet e furnizimit te saj
- ◆ Sistemi i kontrollit te peshes se ushqimeve qe hyjne dha dalin nga magazina
- ◆ Sistemi i kontrollit te parametrave te ambjentit
- ◆ Sistemi i zenies ruajtjes frigoriferike dhe shperndarjes se peshkut.
- ◆ Sistemi i grumbullimit dhe perpunimit te mbetjeve

Projekti do te zbatohet ne nje siperfaqe ujore prej 10 ha ne gjirin e Vlores ne anen lindore te gadishullit te Karaburunit perballe gjirit te Raguza 1.

Per zhvillimin e ketij aktiviteti gjiri i Vlores e pikerisht ky breg i Karaburunit afron mundesi optimale.

SHOQERIA “ALMARINA OR”SHPK



1.2 Kerkesat e perdorimit te tokes dhe karakteristika te tjera te projektit.

Zbatimi i ketij projekti nuk paraqet kerkesa specifike per token sepse aktiviteti do te kryhet ne siperfaqe ujore detare.

Gjate funksionimit teknologjik te impantit ndikimet ne toke dhe cilesine e saj jane praktikisht te paperfillshme dhe pa pasoja negative ne ambient. Kete do ta shikojme gjate shtjellimit te ketij raporti.

1.3 Procesi i prodhimit dhe karakteristikat operative te projektit

Tipi dhe sasia e lendes se pare energjise dhe burimeve te tjera te konsumuara.

1.Rasati qe do te populloje impiantin

Duke mbajtur parasysh kushtet qe ofron vendi te cilin shoqeria e ka zgjedhur per ushtrimin e ketij aktiviteti krahasuar keto me karakteristikat dhe kerkesat qe ka kocja dhe levreku , rasati i te ciles do te sigurohet ne

SHOQERIA “ALMARINA OR”SHPK

Greqi e Itali ne nje nga firmat me te njohura ne kete fushe mendojme se eshte bere zgjedhje e mire

2 .Ushqimi

Te ushqyerit e koces dhe levrekut dhe marrja e nje produkti cilesor eshte nje nga objektivat e kesaj kompanie. Ushqimi ka nje rendesi te vecante jo vetem ne nxjerrjen e nje prodhimi cilesor ne treg, por dhe per shendetin e rasatit, pra si rrjedhoje edhe ne mbarevajtjen e ciklit te prodhimit.

Furnizimi me ushqime do te sigurohet nepermjet blerjes nga firma e mirenjohur e prodhimit te ketyre ushqimeve ne Greqi, ose Itali. Perberesit kryesore te ushqimit, qe do te perdoret ne impiant jane te nje cilesie shume te larte dhe te kontrolluara, ne kete menyre sigurohet nje produkt bio i garantuar dhe pa pasoja negative ne mjedis. Ushqimi shperndahet sipas kerkesave teknologjike te rasatit.

3 . Uji i pijshem dhe ai teknologjik

Suksesi i aktivitetit qe po vleresojme si aktivitet qe zhvillohet ne ambient ujqor ne nje perqindje shume te larte varet nga cilesia e ujrave si dhe nga perparesi te tjera qe na ofron vendi te cilin kemi zgjedhur per kryerjen e tij. Vendi ne te cilin do te instalohet impianti i koshave notues eshte nje gji natyror, nga ana lindore e Karaburunit . Ndodhet rreth 9 km nga qyteti I Orikumit dhe 5 km nga baza e Pashalimanit . Pikerisht eshte zone e pabanuar. Bregdeti eshte shkembor i natyres gelqerore ku mbizoteron shkurja karakteristike mesdhetare bregdetare.

Zona ne fjale ka qene dhe eshte akoma zone ushtarake, e pa banuar, ne nje largesi te konsiderueshme nga qendra me e afert e banuar, per pasoje e pa shkelur nga popullsia, pra praktikisht ujqrat e saj dhe tereni perreth eshte shume i paster dhe pa mbetje urbane.

Batice – zbatica ne gjrin e Vlores eshte e rregullt dhe ka nje periode prej 12 oresh . Karakterizohet prej lekundjesh me amplitude te vogel. Keshtu amplituda mesatare ditore ne 50% te rasteve ka nje vlere prej 20-25 cm dhe vetem 1% te rasteve kjo kap vleren prej 40-49 cm. Vlera maksimale e vrojtuar e amplitudes mesatare ditore eshte 55 cm. Thellesia mesatare e gjirit ne vendin qe shoqeria mendon te instaloje koshat rreth 35-50 m duke ofruar keshtu nje raport me se optimal (rreth 5 me 1)

SHOQERIA “ALMARINA OR” SHPK

me thellesine e koshit, gje qe siguron mundesi shume te mira per vete pastrimin e ujrave te gjirit dhe uljen ne maksimum te efekteve negative te mbetjeve ushqimore dhe jetesore, si per popullaten e peshqve ne kosha , ashtu dhe per gjithë jeten e gjallesave ne gji si “ Flore , faune “ jashte koshave te impiantit .

Temperaturat mesatare te ujit ne kete gji ne thellesine ku do te instalohen koshat, krahasuar me kerkesat e teknologjise afrojne kushte shume te mira per nje zhvillim intensiv dhe pa strese te rasatit ne rritje.

Sipas teknologjise temperaturat maksimale te ujit ne periudhen e veres, ne muajt korrik-gusht, mbi te cilat popullata e peshqve ne rritje frenon ritmet e zhvillimit eshte 25⁰C.

Edhe per temperaturat minimale krahasuar me kerkesat e teknologjise kemi konstatuar vlera optimale deri 9,5⁰ qe percakton teknologjia per periudhen e dimrit

4- Energjia elektrike .

Funksionimi normal i impiantit nuk ka nevojë per perdorimin e energjise elektrike.

5- Ambalazhimi dhe transporti

Per ambalazhimin e peshkut per treg do te perdoren arka plastike, ndersa per transport do te perdoret nje kamion autofrigorifer prone e subjektit.

Mbetjet dhe emetimet.

a- Shkarkimet ne uje

Per realizimin me sukses te projektit, cdo nderhyrje qe eshte planifikuar te kryhet nga shoqeria, do te behet e mbeshtetur rreptesisht ne kerkesat e teknologjise me te perparuara bashkekohore, qe aplikohet aktualisht ne Greqi, Itali, France.

I gjithë materiali i zgjedhur per ndertimin dhe instalimin e impiantit perbehet prej lende plastike dhe druri , duke shmangur totalisht perdorimin e materialeve metalike ne kontakt me ujin dhe per pasoje ndikimet negative te ketyre materialeve ne ambient, praktikisht mendojme se jane te paperfillshme .

SHOQERIA “ALMARINA OR” SHPK

Ne projekt nuk perfsihen ndertime ne zonen e instalimit te impiantit , sepse shoqeria te gjitha ambjentet e domosdoshme, per nje funksionim normal te aktivitetit sic jane zyrtat , magazinat, dhomat teknologjike etj, do ti ndertoje ne Orikum ne zonen urbane te tij, keshtu qe ndikime negative ne ambjent, qe vijne nga prezenca e objekteve te mesiperme, ne zonen e impiantit nuk ka. Ketu do te kete vetem nje godine modeste per punonjesit e pajisur me banjo me grope septike, duke shmangur derdhjet e çdo lloj shkarkimi tjetër direkt ne det.

Te vetmet mbetje te mundeshme qe krijon ky aktivitet jane:

Mbetjet jetesore te popullates se rasatit ne rritje (ekstremetet), ne rastin me te keq behet fjale per 0.5-1 kg ne dite, si dhe 3-5% te ushqimit ditor.

Per vete kushtet qe ploteson vendi ku do te instalohet impianti, si raport 1/4 midis thellesise se koshit dhe thellesise se ujit, rrymat qe krijon si pasoje e procesit batice-zbatice, si dhe e ererave, pikerisht krijon kushte qe vet pastrimi i ambjentit, ne kete rast i ujit, te jete total , te mos krijoje asnje mbetje ndotese dhe me pasoje negative .

Pra gjate zbatimit te projektit te propozuar nga shoqeria “ALMARINA OR” sh.p.k. nuk do te kete mbetje qe do te ndotin mjedisin uxor apo ate tokesor.

b- Emetimet ne ajer

Per te plotesuar nevojat per oksigjen te rasatit ne rritje, ne impiant nuk do te vendoset asnje pajisje e vecante , sepse ne kosha do te kemi ne çdo moment uje te fresket, me perqindje optimale oksigjeni, si pasoje e nderrimit te tij te vazhdueshem per efekt te rrymave te vazhdueshme qe krijon nga efekti i batice- zbatice , keshtu qe ne çdo moment nevojat per oksigjen te rasatit do te plotesohen ne parametra optimale

Duke qene se impianti nuk perdor asnje pajisje, emetimet e mundeshme ne ajer, si pluhurat apo lende te tjera te kesaj natyre, zhurmat, vibracionet , nxehtesia, jane praktikisht te nivelit zero dhe pa pasoje negative ne ambjent.

c- Depozitimet, mbetjet ne toke dhe dhera,

Gjate punes normale te impiantit , te vetmet mbetje do te jene sasira rasati qe mund te ngordhin dhe qe perfaqesojne ne rastin me te mire 0.5-1 kg ne dite Per perpunimin e tyre, subjekti do te ndertoje nje grope septike ne te cilen keto mbeturina do te perpunohen me klor dhe gelqere te pa shuar .

Mund te themi qe ne impiant nuk krijohen depozitime dhe mbetje te demshme ne toke dhe dhera.

SHOQERIA “ALMARINA OR” SHPK

d- Vendet dhe proceset alternative te mara ne konsiderate

Shoqeria “ALMARINA OR” sh. p. k. ne perzgjedhjen e ketij vendi per te ushtruar aktivitetin qe po analizojme, ka patur parasysh sa me poshte:

Vendi me te cilin do te instalohet impianti i koshave notues eshte nje gji natyror, nga ana lindore e Karabrunit perballe vendit e quajtur Raguza 1. Ndodhet rreth 9 km nga qyteti i Orikumit dhe 5 km nga baza e Pashalimanit Praktikisht eshte zone e pabanuar. Bregdeti eshte shkembor i natyres gelqerore , ku mbizoteron shkurja karakteristike mesdhetare bregdetare.

Zona ne fjale ka qene dhe eshte akoma zone ushtarake, e pa banuar, ne nje largesi te konsiderueshme nga qendra me e afert e banuar, per pasoje e pa shkelur nga popullsia, pra praktikisht ujrat e saj dhe tereni pereth eshte shume i paster dhe pa mbetje urbane .

SEKSIONI 2

Pershkrimi i vendit dhe mjedisit te tij

2.1- Tiparet fizike

2.1- Popullsia me perafersi

Impianti me te cilin analizojme , do te instalohet rreth 9 km larg qendres me te afert te banuar , qe eshte ajo e Orikumit , me rreth 4500 banore , si dhe 30 km nga qyteti i Vlores

2.2- Flora dhe fauna (duke perfshire habitat)

Sic thame vendi ku do te zhvillohet ky aktivitet ndodhet ne gjirin e Vlores . Gjiri i Vlores megjithese ka nje siperfaqe te kufizuar pyjore , shquhet per diversitet dhe shumellojshmeri te llojeve . Keshtu dallohen qarte te kater brezat bimor vertikal , nga makja te kullotat verore.

SHOQERIA “ALMARINA OR” SHPK

Nder llojet me karakteristike te zones dallohet mare, shqopa, mrete , peralli, dellinja , driza, lisi, valanidhi, pisha, bredhi, ahue dhe disa lloje bimesh barishtore.

Krahas me demtimin masiv te mbuleses pyjore , te ndodhur 10 vjeçaret e fundit ka ardhur duke u zvogeluar edhe fauna .

Keshtu shume kafshe te egra qe kane ekzistuar , aktualisht jane zhdukur apo jane drejt zhdukjes .

Nder kafshet me te njohura te kesaj zone jane derri i eger (Karaburun , Llogara) , ujku , dhelpra, lepuri, baldoza, etj.

Shpendet jane te shumte si lloje(rreth 70) , te cilat ne kete zone gjejne kushte te favorshme ushqimi edhe dimerimi

2.3 – Tokat , kategoria e tokes , gjeologjia dhe gjeomorfologjia

Nga pikpamja gjeomorfologjike vendi ku ndodhet kompleksi perfshihet ne zonen e akulimit qe perfshin ne pergjithesi, gjithe bregdetin shqiptar te Adriatikut , pikerisht ne pjesen veriore te gjirit te Vlores dhe fare prane vendit per te cilin bejme fjale

2.4 – Uji , akuiferet , rruget ujore , brigjet

Zona me te cilin do te instalohet impianti perfaqeson nje mikro gji te vogel ne pjesen lindore te gadishullit te Karaburunit , nga ana e gjirit te Vlores.

Bregu eshte shkembor, i ashper, i natyres gelqerore, dhe i veshur me bimesine karakteristeike te brezit te makjes mesdhetare

2.5 – Ajri , faktoret klimatike , cilesia e ajrit etj

Zona e projektit ben pjese ne Ultesiren Bregdetare te vendit, qe sipas ndarjes klimatike te Shqiperise ndodhet ne zonen klimatike mesdhetare fushore qendrore . Ajo karakterizohet nga dimra te bute e te laget dhe vera te nxehta dhe te thata . Rreshjet bien kryesisht ne forme shiu , ndersa shtresa e bores eshte e pa perfillshme dhe me kohezgjatje mjaft te shkurter .

Elementet kryesore te klimes se nje zone jane:

a. – Rezatimi diellor dhe diellzimi

SHOQERIA “ALMARINA OR”SHPK

Rezatimi diellor si faktor kryesor i formimit te klimes, paraqitet mjaft uniform, per zonen ne fjale. Sasia vjetore e rrezatimit te pergjithshem diellor qe merr kjo zone eshte mjaft larte . Konkretisht rezulton se gjate nje viti sasia e ketij rrezatimi arrin vleren 1 540 kwh/m². Vlera me e larte arrihet ne Korrik 216.5 kwh/m² dhe ajo me e ulet ne muajin Dhjetor 52.1 kwh/m²

Persa i perket diellizimit kjo zone merr rreth 2762 ore me diell . Vlera me e larte arrihet ne korrik 375 ore dhe ajo me e ulet ne janar me 125 ore.

b- Temperatura e ajrit

Temperaturat mesatare te ajrit ne kete zone jane si me poshte:

Temperatura mesatare me e larte eshte ne muajt korrik / gusht 24.0 gc dhe me e ulta ne muajin janar 9.0 gc.

Temperatura mesatare maksimale variojne nga 13 grade 0c ne janar ne 30 C⁰ ne korrik / gusht

Temperaturat maksimale mbi 30 C⁰ shfaqen qysh ne muajin maj dhe zgjasin deri ne muajin tetor , gjithsej ne kete zone vrojtohen rreth 33 dite me temperatura te tilla.

Duke krahasuar vlerat e temperaturave te kesaj zone me ato te pjeses tjeter te territorit , kjo zone eshte nga me te ngrohtat e territorit shqiptar .

Afersia me detin ben qe temperaturat minimale ne kete zone te mos arrijne vlera shume te ulta .

Numri i diteve me temperatura nen zero ne kete eshte shume i vogel ato, vrojtohen nga muaji dhjetor deri ne mars dhe nuk i kalon 5-6 dite ne vit.

c- Reshjet

Regjistrimi i rreshjeve ne kete zone eshte mesdhetar . Ato bien kryesisht gjate periudhes se ftohte te vitit dhe veçanerisht ne periudhen nendor – shkurt .

Saia e rreshjeve masatare vjetore ne kete zone luhetet ne vlerat 1000-1100 mm shi.

Reshjet ne kete zone bien ne forme shiu , bora 1-2 dite ne vit

d- Lageshtia e ajrit

Ndryshimi i lageshtise relative te ajrit gjate vitit eshte i lidhur ngushte me ecurine e temperatures se ajrit .

SHOQERIA “ALMARINA OR” SHPK

Vlerat me te larta te lageshtise relative te ajrit pergjithesisht vrojtohen ne periudhen e ftohte te vitit dhe ato me te ulta ne periudhen e ngrohte te tij . Gjate vitit vlerat e lageshtise relative ne kete zone luhaten nga 62% deri ne 69% , ndersa vlera mesatare vjetore shumevjeçare e saj eshte 66%

e.- Era

Ne kete zone gjate periudhes se veres per efekte te afersise me detin mbizoterojne erera nga kuadrati i perendimit , ne muajt e dimrit mbizoterojne ererat e lindjes dhe te jugut,

Shpeitesia mesatare vjetore varion ne kufite 2.5 m/s .

Shpejtesine me te madhe e arrijne ererat qe fryjne nga jugu.

Ne situata te vecanta qe favorizojne shfaqjen e ererave te forta jane vrojtuar erera qe kane arritur shpejtesine deri 40 m/s

2.6 – Trashegimia arkitektonike dhe historike, zonat arkeologjike dhe tiparet e tyre , si dhe te aseteve te tjera materiale .

Qendrat me te aferta te banuara jane qyteti i Orikumit, fshati Tragjas dhe Dukat

Nga pikpamja e trashegimise arkitektonike, historike dhe arkeologjise kjo zone eshte nga me te pasurat e rrethit te Vlores

Rreth 3 km ne jug – perendim te vendit ne studim ndodhet Orikumi – nje nga portet me te lashte te bregdetit te Vlores , i themeluar si vendbanim ne shek. VI –V- te p.e.s. eshte nga me te logalizuarit , qe preu ne monedhen e vet me figuren e Apollonit . Oriku ka qene pjese e tokes se Amanteve

Gjurmet e qytetit te lashte , bashke me teatrin ndodhen sot te fundosur ne uje , ne lagunen e Pashalimanit, ku dallohet muri dhe 27 shkalle te gdhendura ne shkemb.

Kisha e Marmiroit , ndodhet afro 3.5 km ne jug – perendim te vendit ne studim , prane lagunes se Pashalimanit, rreze shpatit lindor te Karaburunit .

Eshte ndertuar ne nje koder te vogel shkembore dhe piktoreske rethuar me pyll , ne ane te cilit burojne ujra te fuqishem.

Kjo kishë eshte i vetmi monument i ralle i kohes bizantine te shek. XII . Ne ndertimin e saj jane perdorur materialet e Orikut antik te renuar .

Kalaja e Gjon Boçarit ndodhet ne vendin e quatur “ Gjembe” ne fshatin Tragjas ndertuar ne shek .XVI . Ka forme drejtekendeshe me mure me

SHOQERIA “ALMARINA OR”SHPK

lartesi deri 5.5 m dhe trascesi 1.2 m . Ndertimi i kesaj kalaje ka lidhje me fisin Boçaraj , themeluesi i saj eshte Gjon Boçari

Kulla e Dervish Aliut eshte ndertuar ne fshatin Dukat , ne krye te tij me qellim mbrojtje eshte tipi “ kulle – keshtjelle “ ku mund te strehoheshin 250-300 luftetare . Kulla ka 45 frengji dhe 96 dritare te vogla tip frengji

2.7- Kuadri i politikave

Aplikimi i projektit te mesiperem ne zonen ku ai do te realizohet, eshte ne perputhje te plote me te gjithe legjislacionin aktual ne fuqi, si dhe politikat e planeve kombetare dhe lokale qe aplikohen ne zone dhe rrethinat e saj .

Nuk bie ndesh ne asnje moment me direktivat e BE per ‘ Zogjte e Eger’ Konventen per trashegimine boterore kulturore apo konventen e Ramsarit .

Seksioni 3

Vleresimi i ndikimeve

3.a – Ndikimet tek njerezit , ndertesat e objekteve te ndertuara nga njeriu

Gjate fazes normale te operimit te projektit nuk do te kete ndikime negative ne :

- Ndryshimet ne popullsi
- Zonat rrethuese dhe peisazh
- Nivelet dhe ndikimet e emetimeve
- Nivelet dhe ndikimet e zhurmave
- Zhvillimin e rrugeve lokale dhe transportin

-Ndertimet , trashegimine arkitektonike dhe historike , tiparet arkeologjike , si dhe vepra te tjera njerezore , vibracionit etj

3.b- Ndikimet ne floren , faunen dhe gjeologjine

RAPORT PARAPRAK I VNM PER AKTIVITETIN “AKUAKULTURE”

SHOQERIA “ALMARINA OR” SHPK

Gjate fazes se operimit normal te projektit nuk do te kete :

- Humbje dhe demtim te habitateve , specieve bimore dhe shtazore
- Humbje dhe demtim te tipareve gjeologjike , paleontologjike dhe fiziografike , si dhe koseguenca te tjera mjedisore

3.c – Ndikimet ne toke

Gjate fazes se operimit normal te projektit nuk do te kete ;

- Ndikime negative fizike, si ne topografi, erozion etj.
- Ndikime negative ne emetime kimike dhe depozitime
- Ndikime negative ne perdorim te tokes dhe burimeve lidhur me te

3.d – Ndikimet ne uje

Gjate fazes se operimit normal te projektit nuk do te kete

- Ndikime negative ne modelin drenazhues te zones, ne karakteristikat e tjera hidrografike si niveli i ujrave tokesore, i rrjedhjes se ujrave nentokesore, i ndotesve, mbetjeve dhe cilesine e ujit .

3.e - Ndikimet ne ajer dhe ne klime

Gjate fazes se operimit normal te projektit nuk do te kete

- Ndikime negative ne nivelin dhe perqendrimin e emetimeve kimike, lendet e vecanta, aromat sulmuese, dhe ndikime te tjera klimatike.

SHOQERIA “ALMARINA OR” SHPK

- Gjithashtu gjate fazes se operimit normal te projektit nuk do te kete asnje ndikim negative nga ndikime te tjera indirekte dhe sekondare qe shoqerone projektin .

Seksioni 4

Masat zbutese

Nga trajtimi i materialit te pergatitur , del qarte se gjate fazes se operimit te projektit, nuk do te kete asnje ndikim me pasoje negative ne mjedis, megjithate shoqeria “ALMARINA OR”shpk ka ne vemendjen e saj çdo moment, zbatimin me rigorozitet te planit te masave teknike qe kane te bejne me :

- Mbjajtjen ne gadishmeri te plote te sistemit te grumbullimit dhe perpunimit te mbetjeve fiziologjike
- Zbatimin me rigorozitet te masave karantinore si dhe te kalendarit te masave veterinare qe do te aplikohen ne impiant

Seksioni 5

Rreziqe te aksidenteve dhe masat zbutese

Meqenese projekti qe propozon shoqeria “ALMARINA OR” sh.p.k. operon ne fushen e akuakultures, ku perjashtohen ne menyre kategorike mbajtja dhe perdorimi i substancave te rrezikshme, si dhe duke zbatuar masat zbutese qe propozon kjo shoqeri, vleresojme qe rreziqet nga aksidente me pasoja te demshme ne ambient gjate operimit normal te ketij projekti nuk do te kete.

Programi i masave per monitorimin e aktivitetit

Shoqeria “ALMARINA OR” shpk per nje zhvillim te qendrushem te aktivitetit, me qellim arritjen e rezultateve sa me te mira, harton kete program masash

SHOQERIA “ALMARINA OR” SHPK

- 1- Sigurimin e rasatit te importuar, te paster nga çdo semundje infektive apo parazitare, te çertifikuar nga vendi i origjines.
- 2- Zbatimin me rigorozitet te masave karantinore ne impiant.
- 3- Kontroll periodik i gjendjes sanitaro-veterinare te rasatit ne mbareshtim, ne baze te grafikut te sherbimeve veterinare, te hartuara per kete qellim.
- 4- Kontroll periodik te ushqimeve te perdorura ne impiant, per ngarkesa mikrobike te tyre.
- 5- Kontrole dhe analiza periodike te ujit, per te percaktuar, shkallen e ndotjes biologjike per efekt te aktivitetit jetesor te rasatit.
- 6- Mbjajtje ne gadishmeri te plote te mjeteve te sinjalizimit, per te evituar aksidentet detare te mundshme.

PERFUNDIME

Bazuar ne ligjin “Per mbrojtjen e mjedisit” dhe ne permbajtjen e terminologjise se perdorur ne ligj konstatohet :

Objekti ekonomi per kultivimin e tregetimin e peshkut, permban elementet e nje ekoprojektimi, duke marre ne konsiderate aspektet e ndikimit ne mjedis.

Ky aktivitet nuk shkakton demtime te mjedisit.

Te gjitha te dhenat per vlersimin e ndikimit ne mjedis, si dhe zbatimi i te gjitha masave higjeno-sanitare te parashikuara gjate funksionimit te objektit, si veprimtari prodhuese, nuk do te shkaktojne dukurine e nderhyrjes ne mjedis, si veprimtari njerezore, qe ndikon ne ekuilibrin natyror.

Bazuar ne normat e lejueshme te percaktuara nga ligjet perkatese mbi ndikimet ne mjedis, projekti i paraqitur nga kjo shoqeri, nuk shkakton ndotje te mjedisit, pra nuk shkakton:

- a- Ndotje te ujit te pijshem.
- b- Ndotje te ujrave siperfaqesore, ose nentokesore.
- c- Ndotje te ajrit
- d- Ndotje te tokes.

3 – Ndertimi dhe veprimtaria e impiantit:

- Do ndikojne ne permiresimin e treguesve ekologjik te mjedisit detar .
- Realizon punesim dhe ne perspektive do te hapi vende te reja pune .

RAPORT PARAPRAK I VNM PER AKTIVITETIN “AKUAKULTURE”

SHOQERIA “ALMARINA OR” SHPK

- Mundeson plotesimin e tregut te brendshem me produkt ihtik te fresket e te cilesise se larte si dhe te mundshem per eksport.
- Meqenese zona perreth eshte zone me perparesi zhvillimin e turizmit, kjo ekonomi ploteson kusht te favorshem per zhvillimin e tij duke siguruar produkt ushqimor ihtik karakteristik te kesaj zone bregdetare e qe eshte shume i kerkuar nga turistet .

Si perfundim mund te themi se duke pare masat qe do te merren ne teresine e tyre ne permbushjen e kerkesave te ligjshmerise mjedisore, teknologjine e thjeshte qe aplikohet ne rruge te modernizuar, impenjimin per realizimin e monitorimeve te shkarkimeve si dhe permiresimit e treguesve tjere mjedisore, mendojme se aktiviteti qe do te kryhet nga ky subject nuk do te kete pasoja negative te dukshme, te cilat mund te sjellin problem me ndikim ne mjedis.


Si perfundim mund te themi se aktiviteti konsiderohet I pershtatshem dhe I pranueshem ne zonen e zgjedhur nga investitori, pa krijuar problem mjedisore per zonen perreth.

Personi juridik “ ALMARINA OR” do ta ushtroje veprimtarine ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fushen e mbrojtjes se mjedisit dhe do te investoje per permiresimin e tij. Subjekti do te mirepresu cdo sygjerim ne te mire te cilesise se punes, si dhe ky aktivitet do beje te mundur zbutjen e papunesise ne kete zone, duke punesuar nje pjese te mire te banoreve te kesaj zone.

Subjekti duhet te mbaje lidhje me Institucinet pergjegjes per mjedisin, do te kryeje monitorimin e vetmonitorimin nga institucione te akredituara dhe do te jete I pergjegjshem me punen e tij per te mos ndotur mjedisin e mos shqetesuar komunitetin e zones perreth.

Pergatiti materialin

Ing. Sulbena BALILAJ


ING. SULBENA BALILAJ
V.N.M E AUDITIM
MJEDISOR-EXSPERTE

RAPORT PARAPRAK I VNM PER AKTIVITETIN “AKUAKULTURE”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

Rruga "Durrësit" Nr. 27 Tiranë, Tel. 04 224 572 Fax. 0 4 270 627 www.moe.gov.al

Nr. 675 Prot.

Tiranë, më 30.10.2006

Vendimi nr. 9, Nr. 223 Regj.

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 268, datë 24.04.2003 "Për çertifikimin e specialistëve, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

"Sulbenaj BALILAJ"

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

L. Xhuveli

Lufter XHUVELI





SHOQERIA "ALMARINA OR" SHPK



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Zhvillimit Ekonomik,
Tregtisë dhe Sipërmarrjes



LICENCË

LN-7464-02-2014	NUIS/NIPT: L46404209F	Emërtimi përshkrues i veprimtarisë
Subjekti: Sulbena Balila		Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (1. Ndikim në mjedis 2. Auditim mjedisor)
Adresa: Vlore, VLORE, Vlore, VLORE, Lagjja Pavarësia, Pallati Riviera 1, Kati 3		
Kodi: III.2.A	Kod tjetër:	
Data e lëshimit: 12/02/2014	Afati i vlefshmërisë: Pa afat	
Kategoria		Kufizime specifike
Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis		Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi
Nënkategoria		Detyrime specifike
Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis		Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi
Veprimtari specifike		Vendi i kryerjes së veprimtarisë
		Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë
Specialiteti		
		Nënshkrimi i sportellit: <u>Blerina Jnica</u> 

SHOQERIA "ALMARINA OR" SHPK

 <p>REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES QENDRA KOMBËTARE E REGJISTRIMIT</p>	 <p>OKR Qendra Kombëtare e Regjistrimit National Registration Center</p>	NUMRI SERIAL: SN-219236-02-14
<h2>ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI</h2>		
Personit të tatueshëm: Suibena Ballaj – Person Fizik		
Statusi: Aktiv		
Me adresë kryesore: Vlore, Vlore, Lagja Pavaresia, Pallati Riviera 1, Kati 3		
I jepet ky numër identifikimi (NUIS): L46404209F		
Afati i veprimtarisë: Nga: deri		
DATA E REGJISTRIMIT 04/02/2014		 QENDRA KOMBËTARE E REGJISTRIMIT 
DATA E LËSHIMIT 05-02-2014		
SPORTELLI I SHËRBIMIT: Vlore		
<small>Kjo certifikatë mbetet pronë e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe duhet të liqet në rast se ka ndryshim të ndonjë detaji (Emri, Mbiemri) i nëpunësit të sportit të tatueshëm. Kjo certifikatë është e disponueshme në formatin elektronik.</small>		

RAPORT PARAPRAK I VNM PER AKTIVITETIN "AKUAKULTURE"